



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE 2016

ZGJIDHJE E TESTIT

Lënda: Teknologji bërthamë

Varianti A

1. Shtimi i % së karbonit në çelik përmirëson: 1 pikë
A) petëzimin;
B) **fortësinë;**
C) rezistencën;
D) farkëtueshmërinë.
2. Vija e ndërprerë në vizatimin teknik, shërben: 1 pikë
A) për paraqitjen e kontureve të dukshme të objektit;
B) për të bërë vijat e simetrisë;
C) **për paraqitjen e kontureve të elementëve të padukshëm të objekteve.**
D) Për të bërë vijat e përmasave.
3. Planimetria është: 1 pikë
A) Paraqitja në vizatim e një zone të caktuar, e parë nga sipër, duke treguar gjithcka;
B) Paraqitje aksonometrike e një objekti ndërtimi;
C) **Paraqitja në letër e një prerjeje horizontale të ndërtesës në lartësinë e dyerve dhe të dritareve.**
D) Plan i përgjithshëm i një zone të caktuar.
4. Mjetet financiare, në një sistem teknologjik, janë pjesë e: 1 pikë
A) Qëllimit
B) Outputit
C) Feedbackut
D) **Inputit**
5. Fortësia e materialeve është: 1 pikë
A) Vetë fizike.
B) **Vetë mekanike;**
C) Vetë teknologjike
D) Vetë kimike.
6. Bashkueset mekanike shërbejnë për: 1pikë
A) bashkimin e akseve;
B) **bashkimin e boshteve;**
C) ingranimin e rrotave me dhëmbë;
D) funksionimin e transmisioneve.

7. Paraqitjet aksonometrike të një ndërtese bëjnë pjesë në : 1 pikë
A) Vizatimet konstruktive
B) Planin e përgjithshëm
C) **Vizatimet arkitekturore**
D) Pamjet dhe prerjet e ndërtesës.

8. Me automatizim të proceseve kuptojmë përdorimin e mjeteve teknike që reduktojnë në maksimum: 1 pikë
A) konsumin e energjisë;
B) ndërhyrjen e makinerive;
C) nevojën e pajisjeve;
D) **ndërhyrjen e njeriut.**

9. Rrethoni përgjigjen e saktë mbi rondelat: 1 pikë
A) **Rondelat janë fletë unazore që vendosen midis detalit dhe dados dhe lehtësojnë shtrëngimin;**
B) Janë detale unazore prej gome, që pengojnë rrjedhjen e lëngjeve.
C) Janë fletë prej gome, që vendosen midis dy detaleve, që puthiten mirë.
D) Janë detale në formë shufre me kokë të profiluar.

10. Formatin **A6** i ka përmasat: 1 pikë
A) 297 x 210
B) 148 x 210
C) **105 x 148**
D) 297 x 420

11. Shterimi i rezervave të burimeve natyrore, përbën një problem të madh për të ardhmen e Teknologjisë dhe kryesisht, rezervat e burimeve të naftës.
a) Analizoni problemin teknologjik dhe Planifikoni hapat e nevojshme për zgjidhjen e tij, bazuar tek burimet alternative. 3 pikë

Përgjigje:

1. *Përcaktojmë problemin, i cili është:*
 - Shterimi i rezervave të vendburimeve të naftës.
 - Mbledhim informacion dhe parashikojmë zgjidhjet e mundshme, si më poshtë:
 - Përdorimi me kriter i rezervave ekzistuese të naftës;
 - Përmirësimi i teknologjive ekzistuese të pasurimit të naftës, për një shfrytëzim më të mirë të rezervave të nxjerra nga nëntoka.
 - Shfrytëzimi i burimeve alternative, si: energjia e ujit, energjia diellore, energjia e erës, e biomasës, etj.
3. *Përzgjedhja e zgjidhjes optimale (më të mirë).*
 - Shfrytëzimi i burimeve alternative, si: energjia e ujit, energjia diellore, energjia e erës, e biomasës, etj.
4. *Realizimi i zgjidhjes optimale (të përzgjedhur).*
 - me sistem teknologjik, ku, qëllimi është: "Shfrytëzimi i burimeve alternative"
5. *Vlerësime dhe korrigjime mbi zgjidhjen e problemit.*

12. Plotësoni tabelën e mëposhtme me materialet teknologjike, që përdoren për çdo element konstruktiv të ndërtesës. **3 pikë**

Përgjigje:

Themeli	Muret	Kolonat
Gurë, çakëll,	Tulla, dru.	Beton arme
Beton, beton arme	Gurë, qerpiç	Çelik
Blloqe betoni	Beton, xham, etj	Tulla të plota

13. Teknologjia e shërbimeve të transportit është zhvilluar shumë.

- a) përcaktoni llojet kryesore të transportit
b) Jepni shembuj të mjeteve të transportit tokësor

2 pikë
1 pikë

Përgjigje:

a) Llojet e transportit janë:

Transporti tokësor.

Transporti ujor

Transporti ajror

Transporti hapësinor

b) automjetet kryesore që përdoren në transportin tokësor janë:

autovetura, autobuza, kamiona, furgona, treni, etj


14. Në industrinë mekanike mekanizmi bjellë-manivelë ka një përdorim të madh praktik.

- a) Tregoni se ku përdoret ky mekanizëm. **1 pikë**
b) Vizatoni paraqitjen skematike të tij dhe përcaktoni ligjin e shndërrimit të lëvizjes në këtë mekanizëm. **2 pikë**

Përgjigje:

a) Mekanizmi bjellë-manivelë, përdoret tek MDB dhe tek pompat hidraulike.

b) Paraqitja skematike e mekanizmit bjelle-manivele.



Ai shndërron lëvizjen rrotulluese të njëtrajtshme në lëvizje drejtvizore vajtje-ardhje dhe anasjelltas.

15. Bashkimet me kiaveta kanë përdorim të gjerë në mekanikë.

- Përcaktoni tipin e lidhjes që formohet me përdorimin e kiavetave.
- Krahasoni lidhjen me kiaveta me atë me shlica.

1 pikë

2 pikë

Përgjigje:

a) Lidhjet me kiaveta janë lidhje të zërthyeshme.

b) Krahasuar me lidhjet me shlica kanë anë të përbashkëta si :


Janë të dyja lidhje të zërthyeshme dhe shërbejnë kryesisht për lidhjen e boshteve me rrotën.

Përsa i përket ndryshimeve :

Lidhjet me shlica janë më të qëndrueshme për momentet e mëdha rrotulluese.

16. Jepet trupi në aksonometri. Plotësoni 2 pamjet e tjera që mungojnë

2 pikë



17. Zhvillimi i teknologjisë ka ndikuar pozitivisht në disa drejtime kryesore të jetës.

Tregoni se cilat janë përfitimet kryesore që ofron teknologjia për njeriun

3 pikë

Përgjigje:


Përfitimet nga teknologjia janë:

- Rritja e vëllimit dhe e llojshmërisë së prodhimeve dhe shërbimeve;
- Lehtësimi i punës dhe rritja e sigurisë në punë;
- Rritja e cilësisë së punës;
- Zgjerimi i mundësive të informimit dhe të komunikimit;
- Rritja e nivelit të jetesës etj .

18. Të vizatohet projekcioni izometrik i kuboidit të drejtë me bazë katërkëndore me brinjë të bazës: $a=4\text{cm}$; $b=2\text{cm}$ dhe lartësi $h=6\text{cm}$. Ndërtimi i tij të shoqërohet me 3 pamjet në ortogonal. **3 pikë**

Përgjigje:

Izometria dhe 3 pamjet në ortogonal, të kuboidit.



19. Jepet trupi si në figurën e mëposhtme:

a) Ndërto pamjen në horizontal.


1 pikë

b) Ndërto pamjen në vertikal.

1 pikë

c) Realizo prerjen me rrafshin prerës (si në figurë), duke ndjekur rregullat për vijëzimet dhe emërtimin e prerjes.

2 pikë



20. Në planimetrinë e apartamentit të mëposhtëm, plotësoni këto kërkesa:

- a). Përcaktoni tipologjinë e apartamentit. (Si është i organizuar, ai?) **1 pikë**
 b). Plotësoni arredimin e munguar të mjediseve, sipas simbolikës së mësuar dhe shoqëroni atë me një legjendë shpjeguese. **2 pikë**

Përgjigje:

a) *Tipologjia e apartamentit:*

Apartamenti është i organizuar, në tipologjinë: (1+1), pra një dhomë gjumi, një kuzhinë e shoqëruar me dhomë ndenjeje, ballkon, një tualet dhe korridor.

b) *Arredimi i plotë i apartamentit, është si në figurë.*

